

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

RAPORTI I MONITORIMIT TE POLITIKAVE GJINORE


BASHKIA KUÇOVË



2013

Ky raport u hartua nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, në kuadrin e projektit **“Fuqizimi i Qytetarëve për të Monitoruar Axhendën Gjimore Lokale, si një mekanizëm për të garantuar Mirë-Qeverisjen”**.

Publikimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim

Autoret:

Etleva Bisha

Mirela Arqimandriti

Ndihmuan:

Klodjan Laze, Mario Rondo, Shefqet Roshniku, Qemal Roshniku, Brunilda Gjishti, Marjeta Stefa, Josif Xhako, Andrea Rafaeli, Elsa Rafaeli, Kujtim Veizaj, Vasilika Noti, Gladiona Guri, Eneilda Olldashi, Vilma Zhuri, Enerjeta Fishka dhe Valbona Agalliu.

Tiranë 2013

©Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij raporti duhet të bëhen pranë zyrave të Qendrës Aleanca Gjimore për Zhvillim në adresën:

Rr. “Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1,ap.3
Tirana, Albania
Tel.Fax:00 355 4 22 555 14/5
E-Mail: gadc@gadc.org.al

FALENDERIME

Ky raport u përgatit nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me audituesit social nga bashkia Kuçovë. Ne dëshirojmë të falenderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore në prespektivën e çështjeve gjinore dhe personat të cilët morën pjesë në trajnimin “Fuqizimi i Qytetarëve për të Monitoruar Axhendën Lokale Gjinore”.

Ne dëshirojmë të falenderojmë gjithashtu të gjithë ata që ju përgjigjën pozitivisht ftesës sonë për bashkëpunim dhe dhanë kontributin e tyre për përgatitjen e këtij raporti me mbledhjen dhe analizën e informacionit të nevojshëm mbi të cilin është ngritur ky raport.

Ata janë: Bardhyl Gjyzeli (Kryetar/Bashkia Kuçovë), Vehbi Luzi (Drejtore/Zyra e Punës), Klodjan Laze, Mario Rondo, Shefqet Roshniku, Qemal Roshniku, Brunilda Gjishiti, Marjeta Stefa, Josif Xhako, Andrea Rafaeli, Elsa Rafaeli, Kujtim Veizaj, Vasilika Noti, Gladiona Guri, Eneilda Olldashi, Vilma Zhuri, Enerjeta Fishka dhe Valbona Agalliu.

Falenderojmë përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme lokale dhe partive politike për bashkëpunimin e ofruar dhe gadishmërinë për të vënë në dispozicion materiale/raporte etj. apo që u bënë pjesë e intervistave individuale që u zhvilluan në funksion të përgatitjes së këtij Raporti.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim falenderon gjithashtu Ambasadën Amerikane në Tiranë, që përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci ka mbështetur këtë nismë e shumë të tjera për vite me radhë.

PERMBAJTJA

FALENDERIME	3
PERMBAJTJA.....	4
METODOLOGJIA	5
1. ADRESIMI I DHUNËS NDAJ GRUAS NGA AUTORITETET NË NIVELIN LOKAL.....	7
1.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS	7
1.2 BURIMI I TË DHËNAVE.....	7
1.3 REZULTATET	7
1.4 REKOMANDIME	9
2. ZHVILLIMI EKONOMIK	10
2.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS	10
2.2 BURIMI I TE DHENAVE.....	10
2.3 REZULTATET	10
2.4 REKOMANDIME	11
3. PËRFAQËSIMI DHE PJESËMARRJA E GRUAS NË VENDIMMARRJET LOKALE	12
3.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS	12
3.2 BURIMI I TË DHENAVE.....	12
3.3 REZULTATET	12
3.4 REKOMANDIME	15
4. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË GRUPEVE SPECIFIKE	15
4.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS	15
4.2 BURIMI I TË DHËNAVE.....	15
4.3 REZULTATET	15
4.4 REKOMANDIME	17

METODOLOGJIA

Si pjesë e projektit “Fuqizimi i Qytetarëve për të Monitoruar Axhendën Gjimore Lokale, si një mekanizëm për të garantuar Mirë-Qeverisjen”, mbështetur nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim realizoi në muajin prill 2013 një trajnim dy ditor me temë “Fuqizimi i Qytetarëve për të monitoruar axhendën gjimore lokale” me pjesëmarrjen e një grupi qytetarësh të bashkisë Kuçovë.

Trajnimi synonte përgatitjen e pjesëmarrësve si auditues social e për rrjedhojë ata morën njohuritë e nevojshme për të zbatuar në praktikë mjete që e bëjnë zërin e grave të komunitetit të dëgjohet nga autoritetet gjatë proceseve të vendimmarrjes. Përveç njohurive të fituara nga pjesëmarrësit në lidhje me mekanizmat që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale, sfidat që ndeshen në nivelin lokal në drejtim të adresimit të çështjeve të barazisë gjimore, auditit social etj, pjesëmarrësit diskutuan dhe listuan katër çështje kyç gjimore që do të monitoroheshin më pas prej tyre në bashkinë Kuçovë: (i) pjesëmarrja e gruas në vendimmarrjet lokale, (ii) fuqizimi ekonomik i gruas, (iii) dhuna me bazë gjimore dhe (iv) respektimi i të drejtave të grupeve respektive. Ata diskutuan dhe listuan treguesit specifik për secilën prej katër çështjeve, si dhe identifikuan burimet respektive të marrjes së informacionit me qëllim monitorimin e situatës për katër çështjet prioritare në Bashkinë Kuçovë.

Gjatë muajve maj dhe qershor 2013 pjesëmarrësit në trajnim u përfshinë në procesin e monitorimit përmes realizimit të një numri intervistash me drejtues e specialistë të bashkisë së Kuçovës e më gjerë. Produkt i intervistave të zhvilluara dhe i një numri dokumentash të analizuara është ky raport, i cili prezanton problemet, arritjet, sfidat që ndeshen në kushtet lokale për katër çështjet objekt monitorimi, por edhe ofron rekomandime specifike për adresimin e sfidave dhe përmirësimin e situatës.

Për rrjedhojë, në këtë raport gjeni vlerësimin për katër fusha prioritare mbi bazën e indikatorëve specifik:

1. Fuqizimi Ekonomik:

- *Situata dhe reagimi ndaj papunësisë*
- *Përkrahja sociale*

2. Dhuna në Familje

- *Ngritja dhe funksionimi i Zyrës së Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje në Bashki*
- *Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Referimit*
- *Denoncimi i dhunës në familje dhe adresimi nga njësitë përkatëse*
- *Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për denoncimin e dhunës në familje*

3. Pjesëmarrja e Gruas në Vendimarrje

- *Përfaqësimi numerik i gruas*
- *Përfaqësimi substancial, adresimi i nevojave dhe prioriteteve të grave*
- *Ngritja e kapaciteteve të grave*
- *Pjesëmarrja e komunitetit të grave në vendimmarrjet lokale*

4. Respektimi i të drejtave të grupeve specifike

- *Situata e Invalidëve*
- *Situata e Komunitetit Rom*

1. ADRESIMI I DHUNËS NDAJ GRUAS NGA AUTORITETET NË NIVELIN LOKAL

1.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS

Një hap thelbësor për adresimin e dhunës në familje është institucionalizimi i bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë përgjegjës për parandalimin e dhunës në përputhje me ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Megjithatë sistemi i referimit në bashkinë Kuçovë ende nuk është ngritur.

Mungesa të ndjeshme vihen re edhe përsa i përket Zyrës së nënpunësit gjinor pranë bashkisë Kuçovë, përveçse mungesa e fondeve për adresimin e fenomenit e bën pothuajse inegzistent rolin e bashkisë në këtë drejtim.

1.2 BURIMI I TË DHËNAVE

- Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, bashkia Kuçovë
- Nënkryetari i bashkisë Kuçovë

1.3 REZULTATET

- ***Ngritja dhe funksionimi i Zyrës së Barazisë Gjimore dhe kundër Dhunës në Familje në Bashki***

Në bashkinë Kuçovë nuk ekziston një zyrë specifike që të merret në mënyrë specifike me gratë e dhunuara. Nuk ekziston një numër telefoni falas 24 orë në të cilin gratë me probleme të ndryshme që sjell dhuna në familje të mund të kërkojnë ndihmë. Punonjësja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve është gjithashtu përgjegjëse për problemet e dhunës me bazë gjimore.

Nga pikëpamja e infrastrukturës përveçse zyra nuk është e kompletuar me linjën telefonike që të mundësonte shërbimin ndaj komunitetit për të denoncuar dhunën apo për të kërkuar mbështetje në raste dhune, zyra nuk ka as sistem elektronik të regjistrimit të të dhënave mbi rastet e dhunës në familje të denoncuar/kërkuara mbështetje pranë çdo institucioni.

Gjithashtu specialistja që në fokus kryesor ka mbrojtjen e fëmijëve nuk është e trajnuar në lidhje me çështjet e dhunës në familje.

- ***Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Referimit***

Në bashkinë Kuçovë nuk është ngritur ende sistemi i referimit, i cili në fakt duhej të mundësonte koordinimin mes aktorëve të ndryshëm lokal për të parandaluar dhunën në familje, si dhe për të adresuar nevojat e viktimave të dhunës në familje. Në mungesë të këtij sistemi nuk ka një bashkëpunim të institucionalizuar mes institucioneve në nivelin lokal.

- ***Denoncimi i dhunës në familje dhe adresimi nga njësitë përkatëse***

Mungesa e sistemit të referimit, mungesa e një zyre me një numër telefoni falas me shërbim të pandërprerë në të cilin gratë të mund të telefonojnë për të marrë ndihmën e parë, mungesa e strehëzës në të cilën ato të mund të strehohen, dëshmojnë për mosadresimin e duhur të nevojave të grave të dhunuara. Këto mungesa janë faktorë që ndikojnë edhe mbi nivelin e denoncimit të dhunës, pasi ato nuk dinë se ku mund të drejtohen, ndihen të pasigurta dhe heshtin.

Gjatë vitit 2012, numri rasteve të adresuara tek kjo zyrë ishte 15. Për këtë vit nuk ka raste të adresuara në Zyrën e Bashkisë, por kjo nuk do të thotë se rastet e dhunës janë ulur: gratë nuk janë të informuara se ku mund të drejtohen.

Në Bashkinë Kuçovë nuk ekziston një strehëz ku mund të strehohen gratë e dhunuara qoftë dhe për pak ditë. Punonjësja e njësisë u jep këshilla rasteve që paraqiten tek ajo dhe në rastet kur ato janë të vendosura për të denoncuar dhunën i referon në polici dhe deri në gjykatë.

Disa prej grave të dhunuara kanë marr urdhrin e mbrojtjes nga gjykata dhe kështu ndihmohen nga qeveria me një ndihmë ekonomike prej 3 mijë lekësh, e pamjaftueshme kjo për të jetuar.

Në bashkinë Kuçovë nuk ka asnjë fond specifik në ndihmë të grave të dhunuara. Raste shumë të veçanta ndihmohen nga fondi i Bashkisë.

- ***Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për denoncimin e dhunës në familje***

Është e dukshme që iniciativat për informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi dhunën në familje realizohen përmes shoqërisë civile në kushtet kur bashkia nuk ka fonde specifike për adresimin e dhunës në familje.

Në bashkëpunim me Qendrën Rinore janë realizuar disa fushata informimi për ligjin dhe adresimin e dhunës ndaj gruas përmes përgatitjes dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve. Fletëpalosjet janë shpërndarë edhe në zyrën ku gratë marrin ndihmën ekonomike.

Në bashkëpunim me organizatën “SHKEI” me qendër në Tiranë janë organizuar 3 trajnime me nga 15 gra, të grupmoshës nga 18-40 vjeç. Takimet kanë synuar informimin dhe ndërgjegjësimin e grave në lidhje me dhunën.

Duhet të theksojmë se nuk ka fond të veçantë të miratuar nga Këshilli Bashkiak për çështjen e gruas në të gjitha dimensionet e saj. Në fakt gratë janë të përfaqësuara në pozicione vendimmarrëse si në bashki ashtu edhe në këshillin bashkiak e megjithatë zëri i tyre për një buxhet të veçantë për gruan, veçanërisht për adresimin e dhunës në familje, nuk është dëgjuar në këto njësi vendimmarrëse.

1.4 REKOMANDIME

- ***Ngritja e sistemit të referimit*** të rasteve të dhunës në familje është një hap tejet i rëndësishëm që duhet të hidhet menjëherë jo vetëm në respekt të detyrimit ligjor, por edhe si domosdoshmëri për të ndërmarrë veprime të unifikuara mes autoriteteve të ndryshme përgjegjëse në nivelin lokal, gjë që do të prodhonte një adresim real dhe efektiv të nevojave të viktimave të dhunës në familje, si dhe parandalimin e saj.
- Praktikrat e deritanishme të referimit të rastit nga bashkia tek autoritete të tjera lokale deri në marrjen dhe zbatimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes duhet të pasohet me ***veprime konkrete që synojnë mbështetjen psiko-sociale dhe riintegrimin ekonomik*** dhe shoqëror të viktimave të dhunës në familje.
- ***Institucionet shtetërore në nivel lokal***, detyrat e të cilave lidhen me adresimin e dhunës në familje duhet ***të parashikojnë në buxhetet e tyre vjetore fonde specifike*** për këtë qëllim.
- Duhet të ***ngrihet e kompletohet Zyra e Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje***, si dhe ajo duhet të ndërtojë sa më parë ***sistemin elektronik***, ku të regjistrohen të dhënat e rasteve të dhunës.
- ***Fushatat informuese dhe ndërgjegjësuese me publikun*** duhet të vazhdojnë, jo vetëm në lidhje me kuptimin e dhunës në familje dhe pasojat e saj, por edhe në lidhje me njohjen nga komuniteti të institucioneve lokale (veçanërisht Zyrës së Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje), tek të cilat ata duhen të adresojnë problemet dhe nevojat e tyre.

2. ZHVILLIMI EKONOMIK

2.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS

Zhvillimi ekonomik i qytetit të Kuçovës midis të tjerash bazohet në biznesin vendas. Gratë luajnë rol të rëndësishëm në biznesin e vogël dhe në atë ambulant. Konkretisht në bashkinë Kuçovë zhvillojnë aktivitetin e tyre 200 biznese të vogla dhe rreth 70% e tyre drejtohen nga gra.

Sipas Zyrës së Statistikës së bashkisë Kuçovë janë 21.000 banorë të moshës 15-65 vjeç. Ndërkohë, sipas Zyrës së Punës për periudhën 2011-2012 janë regjistruar si të papunë 1405 persona, prej të cilëve 969 janë gra, dhe 81 prej tyre janë kryefamiljare. Papunësia është në rritje në Kuçovë, prandaj hapja e vendeve të reja të punës dhe promovimi i biznesit vendor duhet të konsiderohet prioritar nga autoritetet vendore.

Praktika e ofrimit të kurseve për ngritje profesionale (gjithsesi e limituar), si dhe ofrimin e praktikës së studentëve të sapo diplomuar janë përpjekjet kryesore të bashkisë Kuçovë dhe shoqërisë civile për nxitjen e punësimit dhe rritjen ekonomike.

2.2 BURIMI I TE DHENAVE

- Zyra Vendore e Punësimit
- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike

2.3 REZULTATET

- *Situata dhe reagimi ndaj papunësisë*

Numri i grave të papuna në bashkinë Kuçovë është aktualisht 969 vetë dhe ka një tendencë rritje të papunësisë. 84 prej tyre janë kryefamiljare.

Ka një përpjekje nga ana e bashkisë Kuçovë për të bashkëpunuar me bizneset private me qëllim punësimin e grave kur ato krijojnë vende të reja pune. Këtë vit janë punësuar 5 gra në një rrobaqepësi.

Ndërkohë bashkia ndjek politika stimuluese për biznese që hapen nga gra e vajza duke i përjashtuar nga tatimet për një afat kohor të caktuar, gjithashtu një tjetër lehtësi e krijuar nga bashkia është heqja e taksës së regjistrimit të bizneseve.

Zyra e Punës, një tjetër institucion i rëndësishëm që punon në kushtet vendore me qëllim punësimin, i ka orientuar përpjekjet në tre drejtime kryesore: (1) bashkëpunim me biznesin e vogël dhe të madh, me qëllim punësimin e të papunëve (ku vendin kryesor e zënë gratë e vajzat); (2) ndërmjetësim për punësim në sektorin shtetëror dhe (3) bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse për të organizuar kurse trajnimi për të rinj e të reja.

Përqindja më e lartë e papunësisë tek gratë shënohet tek gratë me arsim të mesëm dhe të ulët, gjë që nxjerr në pah nevojën për formim profesional të tyre me qëllim krijimin e shanseve për të hyrë në tregun e punës. Në kushtet kur në bashkinë Kuçovë mungon Qendra e Formimit Profesional, si dhe mungojnë fonde specifike si në buxhetin e bashkisë ashtu edhe të zyrës së punës, realizimi i këtyre kurseve mbetet në kushtet e bashkëpunimit të këtyre institucioneve me organizatat jofitimprurëse që kanë realizuar projekte për këtë qëllim.

- ***Përkrahja sociale***

Ndihma ekonomike për familjet dhe gratë në nevojë funksionon rregullisht dhe gjen gjithmonë mbështetjen e Këshillit Bashkiak. Nga 7987 familje të qytetit të Kuçovës, 534 prej tyre trajtohen me ndihmë ekonomike. 15 gra kryefamiljare marrin ndihmë ekonomike nga bashkia.

Megjithatë niveli i ndihmës ekonomike është tejet i ulët dhe familjet nuk arrijnë të përballojnë jetesën përmes kësaj ndihme.

Bashkia ndërvepron me kishën katolike dhe Kryqin e Kuq për të siguruar ndihma ushqimore për familjet në nevojë me gra kryefamiljare.

2.4 REKOMANDIME

- Është i nevojshëm bashkëpunimi real mes Bashkisë - Zyrës lokale të Punësimit - bizneseve private për të nxitur punësimin.
- Ngritje e kapaciteteve të Institucioneve Lokale (Bashki, Zyra e Punës etj) për mundësimin e lidhjes me tregun e Punës të kapaciteteve ekzistuese për punë si dhe vlerësimin e situatës aktuale në lidhje me kapacitetet për punë të personave të regjistruar si të papunë;
- Hartimi i Programeve dhe Projekteve nga Pushteti Lokal dhe OJF-të në lidhje me fuqizimin ekonomik të gruas në lidhje me nevojat e tregut të punës;
- Të ofrohen shërbime lokale të posaçme për ndjekjen e kurseve profesionale nga gratë, veçanërisht të grave në nevojë;
- Të ngrihet zëri për rritjen e nivelit të shumës së ndihmës ekonomike për gratë vulnerabël, në mënyrë që të përballohet minimumi jetik.
- Përtej politikave aktuale për nxitjen e punësimit të grave dhe vajzave bashkia duhet të shohë me prioritet edhe ndërmarrjen e iniciativave të tjera siç mund të jetë dhënia e ambjenteve pronë e saj me qera të ulët tek bizneset e administruara nga gratë apo gra kryefamiljare etj.
- Zyra e tatim - taksave duhet të punojë për të sensibilizuar bizneset me qëllim që biznesi familjar të regjistrohet në emër të burrit dhe të gruas, në mënyrë që të dy të përfitojnë nga sigurimet shoqërore.

3. PËRFAQËSIMI DHE PJESËMARRJA E GRUAS NË VENDIMMARRJET LOKALE

3.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS

Në bashkinë e Kuçovës, por edhe në institucione të tjera lokale është i dukshëm respektimi i kuotës së përfaqësimit të grave me të paktën 30%.

Bashkia e Kuçovës ka ngritur mekanizma me qëllim pjesëmarrjen e komunitetit të grave në vendimmarrjet lokale. Mekanizma të tillë e kanë bazën që tek informimi i tyre mbi shërbimet që duhet dhe ofrohen nga autoritetet vendimmarrëse dhe janë të ndryshëm: që nga takime të drejtpërdrejta me vendimmarrësit e deri tek Komisionet Qytetare.

Veçse kur analizojmë më tej përfaqësimin substancial të gruas vëmë re se çështjet, nevojat dhe prioritetet e grave të komunitetit nuk artikulohen sa dhe si duhet në njësi të tilla vendimmarrëse siç është Këshilli Bashkiak.

3.2 BURIMI I TË DHENAVE

- Drejtuesi i Zyrës së Komunikimit me Publikun në bashkinë Kuçovë
- Përfaqësues të partive politike lokale
- Drejtues të organizatave jofitimprurëse lokale

3.3 REZULTATET

- ***Përfaqësimi numerik i gruas:***

Bashkia Kuçovë ka 15 drejtori dhe 4 prej tyre (27%) drejtohen nga gra. Ndërkohë nënkryetarja e Këshillit Bashkiak është grua. Në këshillin e bashkisë Kuçovë 8 nga 25 anëtarë këshilli janë gra, pra mbi 30%, nga të cilat: 6 këshilltare përfaqësojnë Partinë Socialiste, 1 këshilltare Partinë Demokratike, 1 këshilltare Lëvizjen Socialiste për Integrim. Sekretarja e Këshillit është gjithashtu grua.

Në arsim kemi drejtuese të Zyrës Arsimore 1 grua dhe 5 drejtoresha të shkollave 9-vjeçare. Në Zyrën Arsimore 80% e të punësuarve janë gra, si dhe në të gjitha shkollat e rrethit Kuçovë përfaqësimi i gruas arrin në mbi 80%.

Në shëndetësi Drejtoresha e Shëndetit publik është grua dhe përfaqësimi grave në këtë institucion është 60%.

Në zyrën e punës përfaqësimi i gruas është 75%. Në Postë Telekom përfaqësimi i gruas është 80%. Drejtoria e sigurimeve shoqërore drejtohet nga një grua.

Përfaqësimi i gruas në pozicionet drejtuese të partive politike është në nivelet 40-50%. Të gjitha partitë politike, veçanërisht tre partitë kryesore PS, PD dhe LSI adresojnë në programet e tyre çështjen e përfaqësimit të gruas.

- ***Përfaqësimi substancial, adresimi i nevojave dhe prioriteteve të grave:***

Në këshillin e bashkisë Kuçovë nuk ka një komision specifik për trajtimin/adresimin e çështjeve gjinore. Në çdo mbledhje të Këshillit të Bashkisë ftohen të marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile e veçanërisht organizata që përfaqësojnë gruan dhe rininë, të cilat mund të japin mendime dhe të shtrojnë çështje që i përkasin grupit që përfaqësojnë.

Edhe pse gruaja është e përfaqësuar në masën 30% ***në Këshillin Bashkiak nuk ka patur referime/raportime/diskutime specifike për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.*** Kjo situatë mendojmë se është e lidhur me faktin që edhe vetë partitë politike e shohin çështjen e barazisë gjinore të lidhur thjesht me nivelin e përfaqësimit politik të gruas në pozicionet vendimmarrëse e duke anashkaluar tërësinë e nevojave dhe prioriteteve që kanë gratë e komunitetit: punësimin, strehimin, mbrojtjen ligjore, sociale etj.

- ***Ngritja e kapaciteteve të grave***

Avancimi i gruas në politikë është gjithashtu i lidhur me rritjen e kapaciteteve të grave. Bashkia Kuçovë dhe Këshilli Bashkiak kanë realizuar dy programe trajnuese, specifikisht: “Kurs orientimi për këshilltaret gra”, si dhe “Roli i këshillave vendore në menaxhimin e aseteve lokale”.

Gjithashtu partitë politike kanë zhvilluar trajnime të ndryshme si:

- Partia Demokratike ka zhvilluar trajnime me gratë në tema të tilla si: Barazia gjinore, E drejta e gruas në jetën politike, punësimi dhe mirëqenia në familje, si dhe ka ndarë edhe ndihma për gratë në nevojë ekonomike apo kryefamiljare.
- Partia Socialiste ka zhvilluar trajnime të shpeshta me Forumin e Gruas të kësaj partie, me tema të tilla si: Pjesëmarrja e gruas në politikë, pavarësia ekonomike, shoqërore e kulturore e gruas.

- ***Pjesëmarrja e komunitetit të grave në vendimmarrjet lokale***

Bashkia Kuçovë përdor rrugë e mjete të ndryshme për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit dhe grave në vendimmarrjet lokale. Duke e konsideruar informimin si hapin e parë drejt pjesëmarrjes në vendimmarrje ***Zyra e Komunikimit të kësaj Bashkie*** përgatit e boton ***Gazetën lokale*** me 1000 kopje çdo muaj, e cila u shpërndahet falas qytetarëve dhe institucioneve në Kuçovë. Kjo gazetë publikon:

- të gjitha njoftimet e Bashkisë, si mbledhjet dhe takimet e Këshillit të Bashkisë dhe të Kryetarit të Bashkisë,
- aktivitetet mujore të administratës së Bashkisë,
- plan buxhetin dhe fazat në të cilat ai kalon deri në miratim nga Këshilli bashkiak,
- aktivitetet e ndryshme të institucioneve social-kulturore-sportive,
- përkrahjen sociale sipas individëve e familjeve përfituese
- vend të veçantë zënë njoftimet për çdo muaj mbi datë e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë së bashku me tematikën e radhës.

Përmes Zyrës së Komunikimit me Publikun çdo banor i Bashkisë Kuçovë ka mundësinë të adresojë tek kryetari i Bashkisë apo drejtoritë specifike shqetësimet, kërkesat apo sygjerimet për shërbime që i ofrohen nga autoritetet vendore.

Takimet e drejtpërdrejta me Kryetarin e Bashkisë janë gjithashtu një tjetër mundësi që i jepet vazhdimisht çdo banori.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare është një tjetër rrugë e përdorur nga autoriteti vendor për të qëndruar në kontakt me nevojat e prioritetet e grupeve më specifike të komunitetit. Bashkëpunime të vazhdueshme ka pasur me shoqatën e Romëve, Egjiptianëve dhe të Invalidëve. Në këndvështrimin e gruas bashkëpunime konkrete ka me Shoqatën “Gruaja Naftëtare”, shoqatë që vazhdimisht është zëri i grave dhe vajzave të komunitetit, e veçanërisht atyre në nevojë për të zgjidhur probleme të ndryshme social-ekonomike, jo vetëm përmes bashkëpunimit me Bashkinë por edhe me donator të ndryshëm.

Komisioni Qytetar është një tjetër rrugë që e ndihmon bashkinë për të përfshirë në procedurat e përgatitjes dhe miratimit të paketës fiskale dhe buxhetit vjetor këndvështrimin qytetar. 35 përqind e pjesëtarëve të Komisionit Qytetar janë gra e vajza të cilat kanë ngritur në këtë Komision probleme të përfaqësimit e vlerësimit të grave në pozicione drejtuese, mbështetje të grave në nevojë si kryefamiljare e veçanërisht grave të komunitet Rom e Egjiptian. Për këto të fundit është kërkuar veçanërisht punësim e strehim. Është kërkuar gjithashtu miratimi i një buxheti të veçantë për aktivitete të ndryshme për gratë, vajzat, rininë e fëmijët.

3.4 REKOMANDIME

Është tejet e rëndësishme që në fokus tashmë të mos jetë thjesht përfaqësimi numerik i grave, por edhe *përfaqësimi substancial* i tyre. Kjo kërkon që:

- *Vetë gratë e zgjedhura* apo që drejtojnë njësi të rëndësishme vendimmarrëse *të ngrënë më shumë zërin* për të prezantuar e adresuar nevojat e grave të komunitetit e në veçanti të grave më vulnerabël.
- *Autoritetet vendimmarrëse* të mos mbeten thjesht në kushtet e përfshirjes e dëgjimit të nevojave e prioriteteve të artikuluar nga gratë përfaqësuese apo gratë e komunitetit, por *edhe të reagojnë* për adresimin e tyre. Hapi më serioz është miratimi i fondeve që e bëjnë realitet adresimin e këtyre nevojave dhe prioriteteve.

4. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË GRUPEVE SPECIFIKE

4.1 PËRMBLEDHJE E SITUATËS

Bashkia e Kuçovës komunikon e ndërvepron vazhdimisht si me shoqatën e invalidëve ashtu edhe me shoqatën Amaro-Drom. Megjithatë këto grupe specifike përballen me probleme e vështirësi që kërkojnë shumë më tepër angazhim e mbështetje jo vetëm nga Bashkia, por edhe institucione të tjera shtetërore që punojnë në nivelin lokal.

Strehimi dhe papunësia tejet e lartë e komunitetit rom janë dy prej çështjeve që kërkojnë adresim nga institucionet shtetërore. Pengesat infrastrukturore dhe në pajisje mbështetëse janë dy prej sfidave që ndeshin invalidët që banojnë në Kuçovë.

4.2 BURIMI I TË DHËNAVE

- Kryetari i Shoqatës së Invalidëve, dega Kuçovë
- Kryetari i Shoqatës Amaro-Drom, dega Kuçovë

4.3 REZULTATET

- *Situata e Invalidëve*

Në Kuçovë jetojnë 320 persona me invaliditet, nga këta 170 burra dhe 160 gra. 130 prej tyre marrin mbështetje financiare dhe 208 janë kryefamiljarë.

Shoqata e Invalidëve përfaqësohet nga kryetari i saj në Komisionin Qytetar të Bashkisë Kuçovë, gjë që krijon mundësinë që nevojat dhe prioritetet e këtij grupi të artikulojnë në këtë Komision. Ndërkohë shoqata vlerëson së vetëm 10% e kërkesave të tyre janë adresuar nga autoritetet në nivelin lokal.

Problemet kryesore të këtij grupi të popullsisë në Kuçovë e që mbeten ende për tu adresuar janë:

- **Infrastruktura**, e cila krijon pengesa për lëvizshmërinë e tyre dhe aksesin tek shërbimet e ndryshme lokale.
- **Mungesa në mjete ndihmëse**: në karroca dhe proteza invalidi, që i kushtëzon ata të jetojnë vetëm brenda mureve të shtëpisë.
- **Barra financiare** për blerjen e ilaçeve duhet të lehtësohet përmes rimbursimit.

- **Situata e Komunitetit Rom**

Komuniteti Rom në Kuçovë banon në 3 lagje të këtij qyteti. Ai përbëhet nga 139 familje. Nga këto **90% marrin përkrahje sociale nga Bashkia Kuçovë**. Shoqata ka 450 anëtarë dhe drejtohet nga një bord prej 7 anëtarësh, 2 prej të cilëve janë gra.

Problemet më shqetësuese për Komunitetin rom në këtë Bashki janë strehimi dhe punësimi:

- Shifrat tregojnë qartë se nga 139 familje, **45 familje janë pa strehim** dhe jetojnë në barraka ose në ndërtesa shumë të vjetra jashtë kushteve të banimit.
- **Nga 462 persona të moshës 18-60 vjeç të aftë për punë vetëm 7 gra dhe 5 burra janë në marrëdhënie pune.**

Komuniteti Rom në Kuçovë ka një përfaqësues në Komisionin Qytetar të Bashkisë Kuçovë. Përfaqësues të shoqatës i vlerësojnë marrëdhëniet me pushtetin lokal shumë të mira, pasi çdo kërkesë e tyre është marrë në konsideratë jo vetëm nga pushteti lokal, por edhe nga zyrat e punës dhe përkrahjes sociale. Me kërkesën e shoqatës bashkia përmes shërbimit funeral mbulon të gjitha shpenzimet e familjeve në rast fatkeqësish.

Shoqata gjatë tre viteve të fundit ka zhvilluar me pjesëtarë të këtij komuniteti 30 trajnime në fusha të ndryshme:

- të drejtat e komunitetit Rom, shëndetin, arsimin.
- Formim profesional, marrëdhëniet familjare, martesat në kohë të hershme, HIV/AIDS etj.

Gjatë periudhës 3 vjeçare janë trajnuar rreth 60% e grave e vajzave rome.

Dhuna në familje është një tjetër problem shqetësues, por personat e dhunuar nuk deklarojnë dhunën pranë shoqatës apo tek institucionet shtetërore. Kjo për shkak të mungesës së informimit si mbi fenomenin ashtu dhe mbi institucionet ku një person i dhunuar mund të drejtohet. Ka patur raste kur është kërkuar shërbim nga personeli shëndetësor dhe prej tyre është kërkuar pagesë ose rryshfet.

4.4 REKOMANDIME

- Përfshirja e përfaqësuesve të grupeve specifike në proceset vendimmarrëse nga bashkia Kuçovë është për tu përshëndetur, por bashkë me përfaqësimin i rëndësishëm është edhe reagimi i institucionit për ti adresuar realisht me masa konkrete nevojat e artikuluar të këtyre grupeve.
- Drejtues të Shoqatës së Invalidëve rekomandojnë :
 - Të shikohet mundësia e udhëtimit falas të tyre ose kundrejt një çmimi më të ulët
 - Të krijohen lehtësira për taksat për invalidët
 - Të rritet masa e pensionit
- Përpjekjet e Shoqatës Amaro-Drom për të trajnuar pjesëtarë të komunitetit rom jo vetëm mbi të drejtat e tyre, por edhe për formim profesional duhet të pasohen nga veprimi konkret i autoriteteve shtetërore veçanërisht për të nxitur punësimin e këtij komuniteti.
- Bashkia dhe në tërësi institucionet që ligji u përcakton detyrime për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje duhet të ndërmarrin iniciativa konkrete në lidhje me dhunën në familje në komunitetin rom.